



Nr. 3717 Prot
21. 3. 03. 2021

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DURRËS

V E N D I M

Nr. 27, datë 30. 3.2021

“PËR MIRATIMIN E PLANIT TË DETYRUAR VENDOR PËR ZONAT E DËMTUARA PIKËSORE, PËR 130 BANESA INDIVIDUALE, BASHKIA DURRËS”

Në mbështetje të nenit 8, pika 2, neni 9, pika 1/1, shkronja”b” dhe nenit 23, pika 14 e Ligjit Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, Ligjit Nr. 97/2019 “Për miratimin e Aktit Normativ Nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, të Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, i ndryshuar, të Vendimit Nr. 887, datë 24.12.2019 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e rregullave dhe procedurës së përshpejtuar për hartimin dhe miratimin e Planit të Detyruar Vendor, si dhe procedurës së miratimit të Lejeve të Zhvillimit/ Ndërtimit, në rastet e fatkeqësisë natyrore”, të Vendimit Nr. 686, datë 22.11.2017 të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e Rregullores së Planifikimit të Territorit”, të ndryshuar, të Vendimit të Komisionit Shtetëror të Rindërtimit, Nr. 74, datë 01.02.2021, pika 15 “Të miratojë rindërtimin në të njëjtin truall, të njësive individuale të banimit, të vlerësuara “për shembje”, referuar akt ekspertizës së thëlluar të Institutit të Ndërtimi sipas kërkesës me nr. 15568 prot., datë 29.12.2020 të Bashkisë Durrës, për rindërtimin e 104 njësive individuale të banimit, në zbatim të Vendimit të Këshillit Bashkiak Nr.104, datë 30.10.2020 dhe listës bashkëlidhur”, pika 16 “Të miratojë rindërtimin në të njëjtin truall, të njësive individuale të banimit, të vlerësuara “për shembje”, referuar akt ekspertizës së thëlluar të Institutit të Ndërtimi sipas kërkesës me nr. 14169 prot., datë 20.11.2020 të Bashkisë Durrës, për rindërtimin e 17 njësive individuale të banimit, në zbatim të Vendimit të Këshillit Bashkiak Nr.114, datë 30.10.2020 dhe listës bashkëlidhur”, pika 17” Të miratojë rindërtimin në të njëjtin truall, të njësive individuale të banimit, të vlerësuara “për shembje”, referuar akt ekspertizës së thëlluar të Institutit të Ndërtimi sipas kërkesës me nr. 381 prot., datë 12.01.2020 të Bashkisë Durrës, për rindërtimin e 9 njësive individuale të banimit, në zbatim të Vendimit të Këshillit Bashkiak Nr.132, datë 24.12.2020 dhe listës bashkëlidhur”

V E N D O S A:

1. Miratimin e Planit të Detyruar Vendor për Zonat e Dëmtuara Pikësore, për 130 banesa Individuale, Bashkia Durrës, në funksion të procesit të rindërtimit, sipas rregullave dhe procedurave të parashikuara në aktet normative në fuqi, pjesë e të cilit janë dokumentet e mëposhtme:

- a) Raporti i Planit të Detyruar Vendor për Zonën e Dëmtuar Pikësore;
 - b) Materiali hartografik:
 - i. Harta e Përdorimit të Tokës dhe Projektimit Urban;
 - ii. Harta e Infrastrukturave dhe Mbrojtjes së Tokës;
 - c) Paketa e Planvendosjeve për banesat individuale.
2. Miratohet rindërtimi në Zonat e Dëmtuara Pikësore, sipas përcaktimeve të Planit të Detyruar Vendor për Zonat e Dëmtuara Pikësore, me qëllim rindërtimin e objekteve të cilat referuar akt-ekspertizës së thelluar dhe oponencës teknike nga Instituti i Ndërtimit janë shpallur me rrezikshmëri të lartë dhe për shembje të detyruar.
 3. Ngarkohet Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit për botimin e Planit të Detyruar Vendor për Zonat e Dëmtuara Pikësore, për 130 banesa Individuale, në Regjistrin Kombëtar të Planifikimit të Territorit brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga data e miratimit të tij.
 4. Plani i Detyruar Vendor për Zonat e Dëmtuara Pikësore, për 130 banesa Individuale, të integrohet me dokumentin e Planifikimit në fuqi, duke ndjekur përcaktimet e Vendimit Nr. 686, datë 22.11.2017, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e Rregullores së Planifikimit të Territorit”, të ndryshuar.
 5. Ngarkohet Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.
 6. Ky Vendim hyn në fuqi pas botimit në Regjistrin Kombëtar të Planifikimit të Territorit.

KRYETARI

EMIRIANA SAKO

